Press Release

Tirana 16 November 2026

National Gallery of Arts of Albania launches new programme under the direction of Adela Demetja

An exhibition series for mid-career Albanian artists marks the Gallery's return ahead of the reopening of its expanded building in Summer 2027

The National Gallery of Arts of Albania returns to the public with a new series of solo exhibitions by mid-career Albanian artists. It begins with *My heart stops missing a beat, every time!*, a new anamorphic video installation by Lek M. Gjeloshi (b. 1987), opening on 29 November at HangArt, Tirana. Curated by Adela Demetja, the series is the first major initiative under her direction. Appointed in September 2025, Demetja is the first woman to lead the institution in its 72-year history.

The programme invites significant positions in contemporary Albanian art to develop new commissions. It will unfold at HangArt, a temporary venue in the Kinostudio complex made available by the Ministry of Tourism, Culture and Sport, while the National Gallery of Arts undergoes an extensive redevelopment combining the restoration of its historic building with the construction of a new one. Scheduled to reopen in 2027, the expanded museum will encompass approximately 12,020 square metres of total floor area, including new exhibition spaces, conservation and research facilities, and areas dedicated to education and public engagement.

"As the country's leading public institution for the visual arts, the National Gallery has a responsibility to ensure continuity, professional standards and long-term visibility for Albanian art. Our role goes beyond exhibiting, we want to actively contribute to building a sustainable artistic ecosystem."

— Adela Demetja, Director of the National Gallery of Arts of Albania

The exhibition

My heart stops missing a beat, every time! revolves around the geography of the island of Tristan da Cunha in the South Atlantic, one of the most isolated places on the planet. Near its summit, at an altitude of over 2,000 metres, volcanic formations have created a lake in the shape of a dark heart. Because of the terrain, it remains almost inaccessible, even to the island's own inhabitants.

Gjeloshi builds the work from satellite and virtual imagery, abstracted through digital processing. Across two HD channels, shown in an anamorphic view conceived for the HangArt space, the video unfolds rhythmically while the lines of the meridians remain visible: marks that belong fully neither to nature nor to human presence.

Seen from above, the heart reads both as a geological warning and as a concealed intimacy. The artist frames it as an almost impossible encounter, imagined through a kind of romantic science fiction in which speculation becomes the only way to approach a reality that cannot be touched. At this distance, the heart no longer stands for a familiar feeling. It becomes a strange and inexplicable phenomenon. A soundtrack by Kolë Laca, produced in collaboration with Gjeloshi, accompanies the video installation, expanding its sensory and atmospheric dimensions and drawing the viewer into a more immersive experience of the work. The exhibition will also feature an accompanying text by artist Adrian Paci, offering a further perspective on the work and its conceptual exploration.

The National Gallery of Arts

Founded in 1954, the National Gallery of Arts of Albania (Galeria Kombëtare e Arteve, GKA) is a state institution under the Ministry of Tourism, Culture and Sport. Closed for redevelopment since 2021, the Gallery is expected to reopen in Summer 2027, following the restoration of its historic building, inaugurated in 1974 on Martyrs of the Nation Boulevard, and the construction of a new extension. The expanded museum will offer additional exhibition spaces and modern facilities for conservation and research, with the aim of making Albania's artistic heritage accessible to a wider public and fostering dialogue with the international art scene.

The Gallery holds the largest public collection of Albanian art: around 4,700 works and more than 30,000 archival holdings, from post-Byzantine iconography and early modernism to Socialist Realism and contemporary practice. Its international core is the Jan Dibbets donation (2000) of 137 works by 57 leading figures of post-war European and American art.

Under Demetja's direction, the Gallery is also resuming acquisitions, which have been suspended since 2011. Socialist Realism accounts for nearly three quarters of the collection, while contemporary practice remains under-represented. The first focus is Albanian video art from

1996 to 2006, the decade in which key local artists produced their first video works.

Gjeloshi's exhibition follows *In the Present – Creativity Fund 2026* (6–15 November 2026), a group exhibition of new works by 16 Albanian artists produced through the Gallery's first open call for new artistic production, launched at the Ministry's initiative.

Notes to Editors

Adela Demetja is a curator, cultural manager and author, based in Tirana. Since September 2025 she has been Director of the National Gallery of Arts of Albania, appointed through an open call. From 2010 to 2025 she was founding director of Tirana Art Lab – Center for Contemporary Art, one of Albania's leading contemporary art institutions. She also founded the Albanian Visual Arts Network (AVAN), Tirana Art Weekend and the alternative curatorial education programme Curating with Care. She curated the Albanian Pavilion at the 59th Venice Biennale (2022), presenting the work of Lumturi Bllоshmi, and co-curated Synime (Ambitions) (2021) at the National Gallery of Arts, the first large-scale exhibition dedicated to women artists from Albania, Kosovo and the diaspora. She holds an MA in Curatorial and Critical Studies from the Städelschule and Goethe University, Frankfurt am Main. As an independent curator, she has collaborated with institutions including the Museum and Gallery MUZA Ljubljana, National Gallery of Arts Tirana, National Art Gallery of Kosovo, Maxim Gorki Theatre Berlin, Portland Institute for Contemporary Art, Project Biennale D-0 Ark Underground Konjic, Action Field Kodra Thessaloniki, Lothringer 13 Kunsthalle Munich, Villa Romana Florence and Haus am Lützowplatz Berlin.

Lek M. Gjeloshi (b. 1987, Albania) lives and works in Shkodër. His multimedia practice explores the alienating effects of liminal spaces. His work has been shown at Manifesta 14, Villa Romana, École Nationale des Beaux-Arts de Lyon, Stacion – Center for Contemporary Art Prishtina, Kunsthalle West, Bazament Art Space, Autostrada Biennale, Manifattura Tabacchi, Zeta Gallery, the Moscow Museum of Modern Art, the National Gallery of Arts of Albania, Naan Gallery and the Art Gallery of Shkodër, among others. He studied Fine Arts at the Academy of Fine Arts in Florence. In 2016 he received the Ardhje Award for emerging visual artists from the Tirana Institute of Contemporary Art, and in 2018 he was artist-in-residence at Residency Unlimited, New York.

The ongoing redevelopment of the National Gallery of Arts, initiated in 2021 and encompassing the restoration and reconstruction of its historic building alongside the construction of a new building, is an investment by the Albanian government managed by the Ministry of Tourism Culture and Sport and carried out with the particular attention and support of the Prime Minister of Albania.

Practical Information

Lek M. Gjeloshi: *My heart stops missing a beat, every time!*
Curated by Adela Demetja

Dates: 29 November – 6 December 2026
Opening: Sunday, 29 November 2026, 5–7 pm

HangArt, Kinostudio, Rruga Aleksander Moisiu 36, Tirana 1005, Albania
Opening hours: Daily, 4–8 pm
Admission: Free

Galeria Kombëtare e Arteve
National Gallery of Arts of Albania

info@galeriakombetare.gov.al
www.galeriakombetare.al

Press contact

Interview requests with Adela Demetja, Director of the National Gallery of Arts of Albania, as well as all press enquiries, may be addressed to Zaida Violan, International Press Officer, at <zaida@zaidaviolan.com>. High-resolution press images are available for download [here].

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

G K A

NJOFTIM PËR SHTYP

Tiranë 16 nëntor 2026

Galeria Kombëtare e Arteve nis një program të ri nën drejtimin e Adela Demetjas

Një cikël ekspozitash vetjake të artistëve shqiptarë në fazën e konsolidimit të karrierës shënon rikthimin e Galerisë përpara rihapjes së godinës së zgjeruar në verën e vitit 2027

Galeria Kombëtare e Arteve rikthehet para publikut me një cikël të ri ekspozitash vetjake të artistëve shqiptarë në fazën e konsolidimit të karrierës. Cikli nis me *"My heart stops missing a beat, every time!"*, një videoinstalacion i ri anamorfik i Lek M. Gjeloshit (l. 1987), që çelet më 29 nëntor në HangArt, Tiranë. I kuruar nga Adela Demetja, ky cikël është nisma e parë madhore nën drejtimin e saj. E emëruar në shtator 2025, Demetja është gruaja e parë që drejton institucionin në historinë e tij 72-vjeçare.

Programi fton artistë me një veprimtari të rëndësishme në artin bashkëkohor shqiptar të realizojnë vepra të reja me porosi. Ai do të zhvillohet në HangArt, një hapësirë e përkohshme në kompleksin e Kinostudios, e vënë në dispozicion nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, ndërkohë që Galeria Kombëtare e Arteve po i nënshtrohet një ndërhyrjeje të gjerë, e cila ndërthur restaurimin e godinës historike me ndërtimin e një godine të re. E parashikuar të rihapet në vitin 2027, Galeria e zgjeruar do të ketë një sipërfaqe totale prej rreth 12.020 m², me hapësira të reja ekspozimi, mjedise për konservimin dhe kërkimin shkencor, si dhe hapësira të kushtuara edukimit dhe përfshirjes së publikut.

"Si institucioni kryesor publik i arteve pamore në vend, Galeria Kombëtare ka përgjegjësinë të sigurojë vazhdimësinë, standardet profesionale dhe prezantimin afatgjatë të artit shqiptar. Roli ynë shkon përtej ekspozimit; duam të kontribuojmë në mënyrë aktive në ndërtimin e një ekosistemi artistik të qëndrueshëm."

— Adela Demetja, Drejtoreshë e Galerisë Kombëtare të Arteve

G K A

Ekspozita

"My heart stops missing a beat, every time!" merr shkas nga gjeografia e ishullit Tristan da Cunha në Atlantikun Jugor, një prej vendeve më të izoluara në planet. Pranë majës së tij, në një lartësi mbi 2,000 metra, formacionet vullkanike kanë krijuar një liqen të errët në formë zemre. Për shkak të terrenit, ai mbetet pothuajse i paarritshëm edhe për vetë banorët e ishullit.

Gjeloshi e ndërton veprën mbi imazhe satelitore dhe virtuale, të abstraguara përmes përpunimit digjital. Në dy kanale HD, të paraqitura përmes një pamjeje anamorfike të konceptuar posaçërisht për hapësirën e HangArt-it, videoja shpaloset ritmikisht, ndërsa vijat e meridianëve mbeten të dukshme: shenja që nuk i përkasin plotësisht as natyrës, as pranisë njerëzore.

Parë nga lart, zemra liqenike shfaqet njëkohësisht si paralajmërim gjeologjik dhe si shenjë e një intimiteti të fshehur. Artisti e përfytyron atë si një takim pothuajse të pamundur, përmes një lloj fantashkence romantike, ku përfytyrimi spekulativ bëhet e vetmja mënyrë për t'iu afruar një realiteti që nuk mund të preket. Nga kjo largësi, zemra nuk përfaqëson më një ndjenjë të njohur, por shndërrohet në një dukuri të çuditshme e të pashpjegueshme. Instalacioni shoqërohet nga një kolonë zanore e Kolë Lacës, e realizuar në bashkëpunim me Gjeloshin, e cila zgjeron përmasën shqisore dhe atmosferike të veprës dhe e përfshin më thellë vizitorin në përjetimin e saj. Ekspozita do të përfshijë gjithashtu edhe një tekst shoqërues nga artisti Adrian Paci, i cili ofron një këndvështrim tjetër mbi veprën dhe kërkimin e saj konceptual.

Galeria Kombëtare e Arteve

E themeluar në vitin 1954, Galeria Kombëtare e Arteve (GKA) është institucion shtetëror në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit. E mbyllur për rikonstruksion që prej vitit 2021, Galeria pritet të rihapet në verën e vitit 2027, pas restaurimit të godinës historike, të përuruar më 1974 në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", dhe ndërtimit të një shtese të re. Galeria e zgjeruar do të ketë hapësira të reja ekspozimi dhe mjedise bashkëkohore për konservimin dhe kërkimin shkencor, me synimin për t'ia afruar trashëgiminë artistike të Shqipërisë një publiku më të gjerë dhe për të nxitur dialogun me skenën ndërkombëtare të artit.

Galeria ruan koleksionin publik më të madh të artit shqiptar, me rreth 4,700 vepra dhe mbi 30,000 njësi arkivore, nga ikonografia pasbizantine dhe fillesat e modernizmit te Realizmi Socialist dhe praktikat bashkëkohore. Bërthamën ndërkombëtare të koleksionit e përbën donacioni Jan Dibbets i vitit 2000, me 137 vepra nga 57 figura të rëndësishme të artit europian dhe amerikan të pasluftës.

Nën drejtimin e Demetjas, Galeria po rifillon edhe procesin e blerjeve të veprave të artit, të ndërprerë që prej vitit 2011. Realizmi Socialist përbën pothuajse tre të katërtat e koleksionit, ndërsa praktikat bash-

këkohore mbeten pak të përfaqësuara. Vëmendja e parë aktualisht i kushtohet videoartit shqiptar të viteve 1996–2006, dekadës kur disa prej artistëve kryesorë vendas realizuan veprat e tyre të para në video. Ekspozita e Gjeloshit vjen pas *"Në të Tashmen – Fondi i Krijimtarisë 2026"* (6–15 nëntor 2026), një ekspozitë në grup me vepra të reja të 16 artistëve shqiptarë, të realizuara në kuadër të thirrjes së parë të hapur të Galerisë për prodhime të reja artistike, të ndërmarrë me nismën e Ministrisë.

Shënime për redaksitë

Adela Demetja është kuratore, menaxhere kulturore dhe autore, me bazë në Tiranë. Prej shtatorit 2025 është drejtoreshë e Galerisë Kombëtare të Arteve, e emëruar pas një thirrjeje të hapur. Nga viti 2010 deri më 2025, ajo ishte themeluese dhe drejtoreshë e Tirana Art Lab – Qendra për Art Bashkëkohor, një prej institucioneve kryesore të artit bashkëkohor në Shqipëri. Ka themeluar gjithashtu Albanian Visual Arts Network (AVAN), Tirana Art Weekend dhe programin alternativ të edukimit kuratorial "Curating with Care". Në vitin 2022 kuroi Pavijonin Shqiptar në Bienalen e 59-të të Venecias, me veprat e Lumturi Blloshmit, ndërsa më 2021 ishte bashkëkuratore e ekspozitës "Synime" në Galerinë Kombëtare të Arteve, ekspozita e parë e përmasave të mëdha kushtuar artisteve gra nga Shqipëria, Kosova dhe diaspora. Ka përfunduar studimet master për Studime Kuratoriale dhe Kritike në Städelschule dhe Universitetin Goethe në Frankfurt am Main. Si kuratore e pavarur, ka bashkëpunuar me institucione, ndër të cilat Muzeu dhe Galeria MUZA në Lubjanë, Galeria Kombëtare e Arteve në Tiranë, Galeria Kombëtare e Kosovës, Teatri Maxim Gorki në Berlin, Portland Institute for Contemporary Art, Project Biennale D-0 Ark Underground në Konjic, Action Field Kodra në Selanik, Lothringer 13 Kunsthalle në Mynih, Villa Romana në Firence dhe Haus am Lützowplatz në Berlin.

Lek M. Gjeloshi (l. 1987, Shqipëri) jeton dhe punon në Shkodër. Praktika e tij multimediale hulumton efektet tjetërsuese të hapësirave liminale (kufitare). Veprat e tij janë paraqitur, ndër të tjera, në Manifesta 14, Villa Romana, École Nationale des Beaux-Arts de Lyon, Stacion – Qendra për Art Bashkëkohor në Prishtinë, Kunsthalle West, Bazament Art Space, Autostrada Biennale, Manifattura Tabacchi, Galeria Zeta, Muzeu i Artit Modern në Moskë, Galeria Kombëtare e Arteve, Naan Gallery dhe Galeria e Arteve në Shkodër. Ka studiuar arte të bukura në Akademinë e Arteve të Bukura në Firence. Në vitin 2016 fitoi Çmimin "Ardhje" për artistë të rinj të arteve pamore, dhënë nga Instituti i Artit Bashkëkohor në Tiranë, ndërsa në vitin 2018 ishte artist rezident në Residency Unlimited, Nju-Jork.

Rikonstruksioni në vazhdim i Galerisë Kombëtare të Arteve, i nisur në vitin 2021 dhe që përfshin restaurimin e rindërtimin e godinës historike, krahas ndërtimit të një godine të re, është një investim i qeverisë shqiptare, i administruar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe i realizuar me vëmendjen dhe mbështetjen e veçantë të Kryeministrit të Shqipërisë.

G K A

Informacion

Lek M. Gjeloshi: *My heart stops missing a beat, every time!*
Kuratore: Adela Demetja

Datat: 29 nëntor – 6 dhjetor 2026
Çelja: e diel, 29 nëntor 2026, ora 17:00–19:00

HangArt, Kinostudio, Rruga Aleksandër Moisiu 36, Tiranë 1005, Shqipëri
Orari i vizitës: çdo ditë, ora 16:00–20:00
Hyrja: falas

Galeria Kombëtare e Arteve
National Gallery of Arts

info@galeriakombetare.gov.al
www.galeriakombetare.al

Kontakt për shtypin

Kërkesat për intervista me Adela Demetjan, drejtoreshë e Galerisë Kombëtare të Arteve, si edhe çdo kërkesë tjetër e mediave, mund t'i drejtohen Zaida Violan, përgjegjëse për marrëdhëniet me shtypin ndërkombëtar, në adresën zaida@zaidaviolan.com. Fotografitë për shtypin me rezolucion të lartë mund të shkarkohen [këtu].

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT